

LIGJ
Nr.8394, datë 2.9.1998

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7986, DATË 13.9.1995 "PËR
INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pikat 2 dhe 3 të nenit 2 ndryshohen si më poshtë:

- Me termin "ministër" kuptohet ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.
- Me termin "ministri" kuptohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

Neni 2

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Inspektorati Shtetëror i Punës hyn në marrëdhënie dhe zhvillon një bashkëpunim efektiv me:

- a) ministrinë dhe inspektoratet e varura prej tyre;
- b) Insitutin e Shëndetit Publik, përsa i takon higjienës industriale;
- c) shërbime të tjera dhe institucione që kryejnë veprimtari të ngjashme;
- ç) organet e policisë;
- d) gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Mënyrat dhe format e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e lartpërmendura rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose me marrëveshje dypalëshe.

Neni 3

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

- a) Në shkronjën "b" të pikës 1 pas fjalës "anketimi", shtohen fjalët "apo fotografimi".
- b) Në fund të pikës 1, pas paragrafit të katërt, shtohet paragrafi i pestë si vijon:
"v) të kërkojë identitetin e punëmarrësit."

Neni 4

Në nenin 17, në rreshtin e dytë dhe të tretë hiqen fjalët "të nxjerrë nga Inspektori i Përgjithshëm".

Neni 5

Në nenin 25, pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

- a) Pika 1 ndryshohet si vijon:

"Kundërshtimi dhe pengimi i inspektorëve në ushtrimin e detyrës dënohet me gjobë nga 1 000 deri në 50 000 lekë. Kur shkeljet përbëjnë vepër penale, zbatohen dispozitat e Kodit Penal."

b) Pika 2 shfuqizohet.

Neni 7

Pas neni 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 26/1

Pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës, me urdhër të ministrit, krijohet Komisioni i Apelit të Gjykatave dhe të Vendimeve, i përbërë nga tre anëtarë."

Neni 8

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"Kundër vendimeve të inspektorëve për gjoba deri në 5 000 lekë, bëhet ankim pranë Inspektorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tyre.

Kundër vendimit të Inspektorit të Përgjithshëm për ankimet për gjobat mbi 5 000 lekë, bëhet ankim në Komisionin e Apelit të Gjykatave dhe të Vendimeve, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Kundër vendimit të inspektorit të Përgjithshëm dhe Komisionit të Apelit të Gjykatave dhe të Vendimeve bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve nga dita e dhënies së vendimit."

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2213, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**